

# TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

## Përmbajtja

- I. Seminari i të premtes
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj
- V. Aktivitete të tjera

## I. SEMINARI I TË PREMTES

Tematikat e materialeve të prezantuara në aktivitetin kërkimor “Seminaret e së Premtes”, gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2012, kanë të bëjnë kryesisht me kreditimin dhe përcaktuesit e tyre kryesorë, perceptimet e bizneseve ndaj instrumentave të pagesës, elasticitetin e të ardhurave dhe çmimeve, impaktin e krizës greke etj. Në rubrikën më poshtë do të gjeni një përmbledhje më të detajuar të këtyre materialeve.

### **“PËRCAKTUESIT E KREDISË BANKARE PËR SEKTORIN PRIVAT – RASTI I SHQIPËRISË”, NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE IRINI KALLUCI (DEPARTAMENTI I MBIKQYRJES)**

Ky material fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e përcaktuesve afatgjatë të kredisë së bankave për sektorin privat në rastin e Shqipërisë, duke përdorur një Mekanizëm të Vektorit të Korrigjimit të Gabimit (VECM), bazuar në tregues të kërkesës dhe ofertës. Studimi analizon në të dhëna tremujore përgjatë periudhës

2001-2011. Rezultatet tregojnë se ekziston një mekanizëm korrigjimi që e kthen kreditimin drejt nivelit ekuilibër, si dhe një lidhje pozitive mes kreditimit dhe rritjes ekonomike.

### **“RAPORTI I ANKETIMIT MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESËS – BIZNESET, SHKURT-MARS 2012”, NGA KLITI CECA, ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMEVE TË PAGESAVE)**

Ky anketim synon identifikimin e karakteristikave të bizneseve, të cilat nga ana e tyre ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumentave të pagesave. Anketimi u mundësua nga Banka e Shqipërisë, u konceptua dhe u përpunua nga Departamenti i Kërkimeve, mbështetur nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe nga Departamenti i Statistikës, si dhe u realizua në terren nga INSTAT. Anketimi mbulon zonën Tiranë – Durrës dhe iu drejtua gjithsej 400

bizneseve, gjysma e të cilave pranojnë pagesa nëpërmjet instrumenteve bankare *jo-cash* dhe gjysma tjetër nuk pranojnë pagesa me instrumenta të tilla.

**“EFEKTIVITETI I TAKSËS DANEZE ME BAZË PESHE MBI PRODUKTET E PAKETIMIT: RASTI I PAKETIMEVE PREJ LETRE DHE KARTONI”, NGA ENIAN CELA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Qëllimi i këtij artikulli është analizimi i efektivitetit të taksimit mjedisor zbatuar mbi produktet e paketimit prej letre dhe kartoni, në rastin e Danimarkës. Përmes një analize ekonometrike me të dhëna në panel, analiza përqendrohet mbi ndikimin e taksimit në importet e produkteve në fjalë. Modeli gravitacional i regresionit përfshin importet në vlerë si variabël të varur, ndërkohë që ndikimi i taksimit përfaqësohet nëpërmjet një variabli binar mes variablave shpjegues. Rezultatet tregojnë se taksimi ka qenë efektiv në pakësimin e kërkesës për importe të produkteve në fjalë. Arsyet se përse ka ndodhur një gjë e tillë theksohen në funksion të zbatimeve të ardhshme të kësaj politike për këto produkte.

**“ROLI I KURSIT TË KËMBIMIT NË MODELET E TREGTISË NDËRKOMBËTARE: A QËNDRON KUSHTI M-L NË SHQIPËRI”, NGA BLENDAR HODA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Materiali ka për qëllim vlerësimin e masës së transmetimit të aktivitetit real nga vendet partnere tregtare. Ngadalësimi ekonomik i vendeve të avancuara së fundmi është kthyer në një shqetësim

edhe për ritmet ekonomike të vendeve në zhvillim. Një interes të veçantë ka roli i eksporteve, si promotor alternativ i rritjes ekonomike, si dhe vlerësimi i kushtit Marshall-Lerner në rastin e një ekonomie në zhvillim me eksporte më të ulëta se importet. Kjo e fundit vlerëson efektivitetin e kursit të këmbimit në rritjen e prurjeve monetare nga tregtia e jashtme dhe përmirësimin e balancës së jashtme të një ekonomie, nëpërmjet matjes së elasticitetit të flukseve tregtare reale. Rezultatet tregojnë se ndërsa rritja e të ardhurave për frymë është nxitësi kryesor i flukseve tregtare, kursi i këmbimit luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e ritmeve të eksporteve dhe zëvendësimit të importeve.

**“KRIZA EKONOMIKE E GREQISË DHE IMPAKTI I SAJ NË SHQIPËRI”, NGA ENKELA GAÇAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material ka si qëllim kryesor evidentimin e shkaqeve të krizës ekonomike të Greqisë përtej etiketimit të saj si krizë e borxhit. Ai analizon kanalet kryesore si: shpenzimet e mëdha qeveritare, evazionin fiskal, praninë e ekonomisë informale (e cila përbën rreth 25% të PBB-së) dhe korrupsionin, si plagët kryesore të ekonomisë së Greqisë. Gjithashtu, ky studim fokusohet në propozimin e disa zgjidhjeve si reformimi institucional i sistemit gjyqësor e fiskal, dhe shkurtimi i administratës publike, duke theksuar nevojën e ndërthurjes së politikave fiskale me ato të rritjes, në mënyrë që të mundësohet dalja nga rrethi vicioz i deficiteve buxhetore dhe recesionit.

## II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

### **“APLIKIME TË TEKNIKAVE TË VLERËSIMIT TË DENSITETEVE PËR VARIABLAT MAKROEKONOMIKË – ZBATIME PËR RASTIN E SHQIPËRISË”, NGA ALTIN TANKU DHE KLITI CECA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Materiali i diskutimit synon të vlerësojë densitetin e shpërndarjes së vektorëve të rastit, të variablave kryesorë makroekonomikë për Shqipërinë. Objektivi kryesor i këtij aplikimi të ri metodologjik është që të plotësojë dhe mundësisht, të replikojë teorinë e proceseve të rastit në gjenerimin e variablave vektoriale ekonomike, në çdo moment kohe, në një interval kohor të dhënë. Përdorimi dhe identifikimi i një funksioni shpërndarjeje do të synohet të përdoret për të parashikuar vlerat e ardhshme të variablave ekonomike, kur njihen vlerat e shkuara dhe aktuale të tij.

### **“ROLI I PARASË SI NJË SHTYLLË E RËNDËSISHME PËR POLITIKËN MONETARE: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Materiali analizon rolin e parasë si një shtyllë e dytë e rëndësishme për politikën monetare të Bankës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor, atë të stabilitetit të çmimeve. Fokusi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i funksionit të kërkesës për para dhe të shpejtësisë së qarkullimit të parasë së gjerë, M3, në afatin e mesëm dhe të gjatë. Rezultatet tregojnë se kërkesa për para është e qëndrueshme,

edhe pas periudhës së krizës financiare dhe ekonomike, si dhe paraja përmban informacion të rëndësishëm për ecurinë e ardhshme të inflacionit.

### **“EFEKTI I KURBËS-J. NDIKIMI I KURSIT TË KËMBIMIT NË BILANCIN TREGTAR DYPALËSH NDËRMJET SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE KRYESORË TREGTARË”, NGA ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material diskutimi trajton ndikimin që ka kursi i këmbimit në shkëmbimet tregtare dypalëshe, ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë si: Eurozona, Italia, Greqia, Gjermania, Kosova dhe Turqia. Qëllim i vlerësimeve është të evidentojë empirikisht ekzistencën e “kurbës-J” në tregtinë bilaterale, për periudhën 1998-2012. Nëpërmjet “Metodës së korrektimit të gabimit” (*Error Correction Model*) realizohet evidentimi i efekteve afatshkurtra dhe afatgjata që ka nënçmimi i monedhës vendase, mbi bilancin tregtar dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë. Një prej gjetjeve kryesore të materialit është se fenomeni i “kurbës-J” evidentohet vetëm në rastin e tregtisë me Turqinë.

### **“RAPORT I ANKETIMIT MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTAVE TË PAGESËS – BIZNESET, SHKURT - MARS 2012”, NGA KLITI CECA DHE ALBAN PLLAHA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VALENTINA SEMI (DEPARTAMENTI I SISTEMIT TË PAGESAVE)**

Ky anketim synon të identifikojë karakteristikat e bizneseve, të cilat nga ana e tyre, mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në përdorimin e instrumentave të pagesës. Anketimi u mundësua nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT. Anketimi u realizua në zonën Tiranë – Durrës, drejtuar gjithsej 400 bizneseve, gjysma e të cilave pranojnë pagesa nëpërmjet instrumenteve bankare jo-cash dhe gjysma tjetër nuk pranojnë pagesa me instrumente të tilla. Pjesë e analizave të ardhshme do të jenë: përdorimi dhe perceptimi i instrumentave të pagesave ndikuar nga lloji dhe masa e bizneseve, faktorët kryesorë që influencojnë bizneset në përforimin e tyre etj.

#### **“SINKRONIZIMI I CIKLEVE TË BIZNESIT: NJË MATJE E INTEGRIMIT PËR VENDET E EUROPËS JUGLINDORE”, NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Studimi synon të masë nivelin e integritit të ekonomive rajonale, duke u bazuar në treguesit makroekonomik dhe përdor metodologjinë e dekompozimit të krijuar nga Blanchard dhe Quah (1989) nëpërmjet përdorimit të VAR-it strukturor. Gjenerimi i goditjeve nga ana e ofertës dhe e kërkesës në ekonomitë rajonale, tregojnë që lidhjet ndërmjet tyre janë relativisht të dobëta. Gjithashtu, rezultatet tregojnë se goditjet e kërkesës janë më

të sinkronizuara se ato të ofertës. Një shpjegim i mundshëm është veprimi i kanalit tregtar, por jo i kanaleve të tjera strukturore.

#### **“MODELI FINANCIAR PËR SHQIPËRINË: NJË PËRQASJE ME TE DHËNA NË PANEL”, NGA ELONA DUSHKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) DHE VASILIKA KOTA (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR)**

Kriza e fundit globale nënvizoi rolin e rëndësishëm të bankave dhe institucioneve të tjera financiare në transmetimin dhe aplikimin e goditjeve ekonomike dhe financiare. Ky material ka për qëllim prezantimin e një modeli financiar për Shqipërinë, i cili bazohet në analizën e detajuar të bilancit të bankave, për të parë se si goditjet makro-financiare ndikojnë variablat kryesore të modelit. Modeli përmban gjithsej 35 ekuacione, ku 8 janë ekuacione të vlerësuar dhe 27 janë identitete. Variablat e vlerësuar me anë të metodës me panel janë: volumi i kredisë (ndarë për individët dhe bizneset), të ardhurat neto nga interesi, risku i asetit të kredisë, norma e kredive të këqija (ndarë për individëve dhe bizneseve), norma e interesit të kredisë, si dhe kostoja e kredisë. Analiza e simulimeve të ndryshme na lejon të shikojmë se si goditjet kryesore transmetohen në sektorin financiar dhe kthehen sërish në ekonominë reale.

### III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

#### **“IMPAKTI I KRIZËS NË EKONOMINË SHQIPTARE”, NGA Z. ARDIAN FULLANI (GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË), ALTIN TANKU (DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË KËRKIMEVE) DHE LORENA SKUFI (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Studimi është një përshkrim narrativ i zhvillimeve ekonomike në Shqipëri dhe i eksperiencës së saj me krizën. Ky material vë në fokus natyrën e goditjeve dhe efektet e tyre në ekonominë shqiptare, duke u përpjekur të identifikojë dhe të ndajë impaktin mes partnerëve kryesorë ekonomikë. Studimi konkludon se në rastin e ekonomisë shqiptare, disa prej kanaleve kryesore të transmetimit të krizës nuk janë materializuar. Ndërkohë, një element kyç i tkurrjes së aktivitetit ekonomik pas vitit 2008, vlerësohet të ketë qenë rënia e kërkesës së brendshme. Mekanizmi i axhustimit, i cili u mbështet nga politikat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare, tregon se kriza ekonomike e financiare e partnerëve tanë solli ndryshime. Këto ndryshime u shfaqën jo vetëm në kushtet ekonomike, por gjithashtu edhe në një sërë ndryshimesh legjislative e rregullative të politikave, të dizenuara dhe të implementuara konform kushteve të krizës. Si përfundim, themi se ekonomia shqiptare mbetet nën presionin e zhvillimeve të tregjeve të partnerëve tanë kryesorë dhe politikave të tyre ekonomike dhe financiare.

#### **“TENDENCAT AFATGJATA DHE LUHATJET EKONOMIKE NË SHQIPËRI”, NGA BLENDAR HODA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material synon evidentimin e luhatjeve ekonomike në sajë të goditjeve të produktivitetit. Në këtë studim u synua dekompozimi i luhatjeve të ekonomisë në sajë të produktivitetit si faktor afatgjatë i luhatjeve ekonomike, si dhe në sajë të goditjeve reale të përkohshme të identifikuar nga tre tregues kryesorë: prodhimi, konsumi dhe investimet. Në një kuadër të thjeshtë ekonometrik, rezultatet konfirmojnë peshën e produktivitetit në gjenerimin e luhatjeve në horizont kohor më të madh se një vit, ndërsa evidentojnë rolin e goditjeve tranzitore me peshë më të lartë në afatin e shkurtër. Mungesa e goditjeve nominale në këtë kuadër, mund jetë një faktor kuptimplotë për rëndësinë e rezultateve paraprake.

#### **“QËNDRUESHMËRIA FISKALE NË BE DHE VENDET E TJERA KANDIDATE TË MUNDSHME”, NGA GERTI SHIJAKU (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material diskutimi ka në fokus vlerësimin e tipareve të kthimit të raportit të borxhit ndaj PBB-së drejt mesatares historike në afatin e gjatë, në rajone të ndryshme, për periudhën 2000 – 2011. Punimi shqyrton kushtin e aftësisë së shlyerjes nëpërmjet teknikave të testit të rrënjës njësi dhe vlerëson funksionin e reagimit të politikës fiskale në 27 vendet anëtare të BE-së dhe ato candidate, me metodën VAR në panel. Rezultatet e gjetura tregojnë se politika fiskale shfaq inerci të konsiderueshme në sjelljen e saj, si dhe autoritetet fiskale reagojnë sistematikisht ndaj rritjes së raportit të borxhit, duke gjeneruar suficite të ardhshme. Megjithatë, këto suficite janë

të pamjaftueshme për të përmbushur kushtin e aftësisë paguese dhe për të shmangur akumulimin e tij të tepërt.

### **“KRIZA EKONOMIKE E GREQISË DHE IMPAKTI I SAJ NË SHQIPËRI”, NGA ENKELA GAÇAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material ka si qëllim kryesor evidentimin e shkaqeve të krizës ekonomike të Greqisë përtej etiketimit të saj si krizë e borxhit. Në të shkaqet e krizës analizohen, si nga aspekti ekonomik ashtu edhe nga ai politik, duke filluar që nga anëtarësimi i Greqisë në BE deri sot. Ndërsa impakti i saj në Shqipëri analizohet si një nga pasojat e kësaj krize. Gjithashtu, ky studim fokusohet në propozimin e disa zgjidhjeve për reformimin tërësor të ekonomisë së vendit dhe legjisllacionit në terësi, për të mundësuar daljen graduale nga kriza dhe parandalimin e krizave të ardhshme.

### **“NDJESHMËRIA E TREGUT VALUTOR NDAJ LAJMEVE EKONOMIKE”, NGA ILIR VIKA DHE ARLIND RAMA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Analiza e të dhënave në kohë reale mbi të cilën mbështetet ky studim, synon të shpjegojë luhatjet ditore të kursit të këmbimit të lekut ndaj dy monedhave kryesore, euros dhe dollarit. Shpesh herë, luhatjet e kursit të këmbimit të monedhës vendase i atribuohen zhvillimeve në tregjet ndërkombëtare, por jo vetëm. Studimi synon të japë përgjigje mbi rëndësinë dhe ndikimin që kanë në kursin e këmbimit të lekut, njoftimet kryesore ekonomike në Eurozonë, Shtetet e Bashkuara ashtu si dhe lajmet për treguesit kryesorë

ekonomikë vendas. Periudha e shqyrtuar në studim është janar 2007 – korrik 2012, gjatë të cilës kursi i këmbimit ka reflektuar ndikimet e krizës në tregjet financiare. Për këtë arsye, krahas të dhënave nga ekonomia reale, çmimet dhe politikat e ndërmarra ekonomike, vëmendje i është kushtuar edhe treguesve ekonomikë të cilët përdoren për matjen e stresit në tregjet financiare të Eurozonës dhe SHBA-ve. Nga rezultatet paraprake, vihet re se përgjithësisht lajmet pozitive në Eurozonë sjellin dobësimin e lekut. Bën dallim vetëm PBB-ja, rritja e së cilës në Eurozonë shoqërohet me forcimin e lekut. Nga ana tjetër, lajmet ekonomike në SHBA rezultojnë me ndikime të ndryshme. Gjetjet paraprake të studimit janë gjerësisht të ngjashme në madhësi dhe shenjë, me studime të tjera mbi reagimin e kursit të këmbimit USD-EUR, duke na sugjeruar se procesi i gjetjes së çmimit në tregun valutor ndërkombëtar ndiqet ngushtësisht nga aktorët e tregut vendas.

### **“ÇMIMI I BANESAVE DHE LUHATJET E TIJ NË SHQIPËRI”, NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky material synon vlerësimin e luhatjeve në çmimet e tregut të banesave në Shqipëri. Studimi ofron si risi ndërtimin e një indeksi me qëllim matjen e vlerës “reale” të banesave, në bazë të variablave themelore (*fundamentals*) të ekonomisë. Luhatjet e çmimeve aktuale në tregun e banesave do të krahasohen me këtë indeks. Kjo do të shërbejë për të kuptuar nëse luhatjet kanë ardhur si rezultat i faktorëve strukturorë apo i pritshmërive jo të sakta. Vlerësimi do të bazohet mbi metodën VECM.

#### IV. ARTIKUJ

Në këtë rubrikë do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të disa artikujve dhe materialeve të publikuara nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e tjera qendrore, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2012, për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi temat kërkimore shkencore të publikuara gjatë kësaj periudhe.

#### **“TARGETIMI I PBB-SË NOMINALE: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA ENDRIT YZEIRAJ (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE)**

Ky artikull mori shkas nga diskutimi në të cilin janë përfshirë bankat qendrore mbi regjimet monetare. Ai motivohet nga rivlerësimi që po ndodh ndaj regjimit të inflacionit të shënjestruar pas krizës ekonomike botërore dhe efektivitetit të pakët të këtij regjimi gjatë krizës. Artikulli prezanton shkurtimisht teorinë mbi të cilën bazohet targetimi i PBB-së nominale dhe më pas diskuton përshtatshmërinë e tij për rastin e Shqipërisë. Në fund të materialit jepen disa sugjerime modeste në bazë të analizës. Përfundimi kryesor është se aplikimi i një regjimi të tillë mund të hasë probleme në rastin e vendeve në zhvillim si Shqipëria. Patja e një norme rritjeje potenciale përherë në ndryshim, krijon dy vështirësi sipas artikullit. E para, e bën të vështirë matjen e një niveli optimal për PBB-në. E dyta, dhe çfarë është më e rëndësishme, kjo normë rritjeje e ndryshueshme e bën të vështirë komunikimin nga ana e bankës qendrore dhe si rezultat, ancorimi i pritshmërive është jo-optimal.

#### **“KOMUNIKIMI I BANKËS QENDRORE RRETH POLITIKËS FISKALE”, NGA JULIEN ALLARD, MARCO CATENARO, JEAN-PIERRE VIDAL DHE GUIDO WOLSWIJK**

Ky studim investigon empirikisht intensitetin e komunikimit fiskal të 5 bankave qendrore (Banka Federale e ShBA-së, Banka Qendrore Europiane, Banka e Japonisë, Banka e Anglisë dhe Banka e Suedisë) gjatë periudhës 1999-2011, duke ndërtuar një tregues fiskal që mat komunikimin mbi çështje fiskale në minuta apo deklarata hyrëse. Gjetjet e studimit tregojnë se BQE-ja komunikon intensivisht rreth politikave fiskale në terma pozitivë dhe normativë. Ndërsa, bankat e tjera qendrore zakonisht i referohen politikës fiskale kur e përdorin ecurinë e saj, si supozim në parashikimet e tyre, ose kur i referohen përdorimit të instrumentave të borxhit qeveritar në operacionet e politikës monetare. Analiza empirike gjithashtu konstaton se kriza financiare ka rritur intensitetin e komunikimit të bankave qendrore mbi politikën fiskale.

<http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecbwp1477.pdf>

#### **“POLITIKA MONETARE GJATË RECESIONIT: A JANË KRIZAT FINANCIARE SPECIALE”, NGA MORTEN L. BECH, LEONARDO GAMBACORTA DHE ENISSE KHARROUBI**

Politika monetare akomoduese gjatë krizës financiare, luajti një rol të rëndësishëm në parandalimin e një recesioni më të thellë. Megjithatë,

ekzistojnë pikëpamje të ndryshme në lidhje me kohëzgjatjen e këtyre politikave. Pika kryesore e debatit është besimi se një periudhë e zgjatur e politikës monetare akomoduese mund të krijojë shtrembërime. Analiza, bazuar në një kampion prej 24 vendesh të zhvilluara, tregon se politika monetare është më pak efektive gjatë një krize financiare, gjatë të cilës shtrembërime në mekanizmin e transmissimit monetar mund të ndodhin. Në veçanti, rezultatet tregojnë se përfitimet e politikës monetare akomoduese gjatë një recesioni, me qëllim rimëkëmbjen e mëvonshme janë më të paqarta kur recesioni shoqërohet me një krizë financiare. Gjithashtu, studimi konkludon se në sektorin privat, ulja e borxhit gjatë një recesioni ndihmon në nxitjen e një rimëkëmbje të fortë.

<http://www.bis.org/publ/work388.pdf>

### **“POLITIKAT MONETARE DHE MAKROPRUDENCIALE”, NGA PAOLO ANGELINI, STEFANO NERI DHE FABIO PANETTA**

Studimi përdor një model dinamik të ekuilibrit të përgjithshëm (DSGE), i cili përfshin sektorin bankar për të vlerësuar ndërveprimin e politikës makroprudenciale me politikën monetare. Autorët gjejnë se në kohë “normale” (kur cikli i ekonomisë është kryesisht i shkaktuar nga goditje të ofertës), politika makroprudenciale gjeneron vetëm benefite modeste për stabilitetin makroekonomik, në një botë vetëm me politikë monetare. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit makroprudencial dhe bankës qendrore mund të rezultojë në politika konfliktuese, rrjedhimisht në rezultate nën-optimale. Benefitet e prezantimit të politikës

makroprudenciale priren të jenë të konsiderueshme kur goditjet financiare, të cilat ndikojnë ofertën e huave, janë faktorë të rëndësishëm të dinamikave të ekonomisë. Në këto raste, një bankë qendrore bashkëpunuese do të ndihmojë autoritetin makroprudencial përtej stabilitetit të çmimeve, në mënyrë që të përmirësojë stabilitetin e përgjithshëm ekonomik.

<http://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecbwp1449.pdf>

### **“A MUND TË PARASHIKOJNË PERFORMANCËN E BANKËS, TREGUESITË PËRDORUR NË ANALIZËN E REZISTENCËS SË STRESIT”, NGA LUCA GUERRIERI DHE MICHELLE WELCH**

Gjatë analizave të rezistencës së stresit për sektorin bankar, një ndër supozimet e nënkuptuar është se variablat makroekonomikë duhet të jenë faktorë të dobishëm në parashikimin e performancës së bankave. Megjithatë, studimi vlerëson se përveç variablave makroekonomikë, ekzistojnë një sërë faktorësh të tjerë që ndihmojnë parashikimin e variablave financiarë. Kështu, autorët konstatojnë se përdorimi i të dhënave publike mbi performancën e bankave është element i rëndësishëm për parashikim e treguesve të rezistencës së stresit, por në konsideratë duhet të merren edhe tregues të tjerë specifikë. Pavarësisht faktit se modelet kanë përgjithësisht performancë të mirë, parashikimet shoqërohen me banda të larta pasigurie, duke e bërë të vështirë dallimin dhe implikimin që kanë skenarë të ndryshëm makroekonomikë.

<http://www.federalreserve.gov/pubs/feds/2012/201249/201249pap.pdf>



## V. AKTIVITETE TË TJERA

### TAKIMI I GJASHTË RAJONAL: "KËRKIMET EKONOMIKE NË EVROPËN JUGLINDORE", 12-13 NËNTOR 2012

Departamenti i Kërkimeve i Bankës së Shqipërisë organizoi në datat 19-20 nëntor 2012, takimin e gjashtë rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore. Në të morën pjesë mbi 20 përfaqësues (prezantues dhe diskutantë) nga Banka e Shqipërisë dhe bankat qendrore të rajonit, ku përmendim: Bankën e Italisë, Bankën e Kroacisë, Bankën e Maqedonisë, Bankën e Kosovës, Bankën e Turqisë etj. Në vazhden e një tradite të konsoliduar, qëllimi i këtij takimi ishte zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet kërkuesve, jo vetëm në këndvështrimin rajonal por edhe më gjerë. Tematikat e trajtuara mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh dhe problematikash kryesisht mbi: politikat fiskale dhe monetare në një kuadër ekonomik të paqëndrueshëm; krizën globale dhe mekanizmat e transicionit; identifikimin e çekuilibrave në sistemet bankare; vlerësimin e densiteteve në seritë e të dhënave ekonomike etj.

Më poshtë mund të gjeni një renditje të temave të prezantuara në këtë takim.

- "Impakti i krizës financiare mbi ndjeshmërinë financiare të familjeve në Kroaci", nga Ivana Herceg dhe Danijel Nestić, Banka e Kroacisë.
- "Kanalet e transmetimit të krizës ekonomike globale: Mikroevidencë për Republikën e Maqedonisë", nga Biljana Jovanovikj dhe Ljupka Georgievska, Banka e Maqedonisë.
- "Impakti i krizës së borxhit sovran mbi sektorin financiar çek", nga Luboš Komárek, Banka e Çekisë.
- "Kriza ekonomike greke dhe impakti i saj mbi Shqipërinë", nga Enkela Gaçaj, Banka e Shqipërisë.
- "Aplikime të vlerësimeve të densiteteve mbi seritë e të dhënave ekonomike", nga Altin Tanku dhe Kliti Ceca, Banka e Shqipërisë.
- "Identifikimi i çekuilibrave në sistemin bankar hungarez (sistemi i "paralajmërimit të hershëm)", nga Dániel Holló, Banka e Hungarisë.
- "Modeli financiar për Shqipërinë: Një përfaqje me të dhëna në panel", nga Elona Dushku dhe Vasilika Kota, Banka e Shqipërisë.
- "Impakti i konkurrencës në sektorin bankar dhe provigjionet për kreditë e humbura", nga Arben Mustafa, Banka e Kosovës.
- "Krijimi i hartës së stabilitetit financiar në Shqipëri", nga Vasilika Kota, Odeta Minka dhe Arisa Saqe, Banka e Shqipërisë.
- "Përcaktuesit e kredisë bankare ndaj sektorit privat: Rasti i Shqipërisë", nga Gerti Shijaku dhe Irini Kalluci, Banka e Shqipërisë.
- "Efekti i kurbës-J mbi tregtinë bilaterale: Impakti i nënçmimit të monedhës mbi bilancin tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë tregtarë", nga Alban Pllaha, Banka e Shqipërisë.
- "Roli i kurseve të këmbimit në një model të tregtisë ndërkombëtare: A zbatohet në Shqipëri kushti Marshall-Lerner?", nga Bledar Hoda, Banka e Shqipërisë.

- “Ndjeshmëria e tregut valutor ndaj lajmeve ekonomike”, nga Ilir Vika dhe Arlind Rama, Banka e Shqipërisë.
- “Roli i parasë si një shtyllë e rëndësishme për politikën monetare: Rasti i Shqipërisë”, nga Gerti Shijaku, Banka e Shqipërisë.
- “Lajmet, ciklet ekspansion-shfryrje në tregun e shtëpive dhe politika monetare”, nga Birol Kanik, Wei Xiao, Banka e Turqisë.
- “Perceptimi i instrumentave të pagesave nga bizneset shqiptare: Rezultate nga një sondazh publik”, nga Kliti Ceca, Alban Pllaha dhe Valentina Semi, Banka e Shqipërisë.
- “A do të kishte pasur efekt pozitiv të qenit në Eurozonë?”, nga Michal Brzoza-Brzezina, Krzysztof Makarski dhe Grzegorz Wesolowski, Banka e Polonisë.
- “Sinkronizimi i ciklive të biznesit: Një matje e integritimit ekonomik”, nga Endrit Yzeiraj, Banka e Shqipërisë.

Secili nga materialet e prezantuara u shoqërua me një diskutim mbi gjetjet kryesore të materialit, kontributin si dhe komente apo sugjerime përkatëse për përmirësimin e mëtejshëm të punëve të prezantuara.

### **KONFERENCA E SHTATË VJETORE E RRJETIT TË HISTORISË MONETARE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEEMHN), 14 DHJETOR 2012**

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën e Greqisë, organizoi në datën 14 dhjetor 2012, konferencën e shtatë vjetore të rrjetit të historisë monetare për Evropën Juglindore (SEEMHN). Ky rrjet përbën një komunitet historianësh monetarë e financiarë, ekonomistësh

dhe statistikienësh, të krijuar në prill 2006, me iniciativën e Bankës së Greqisë dhe Bankës së Bullgarisë. Mikpritja që Banka e Shqipërisë i bëri Konferencës së Shtatë Vjetore të SEEMHN-së, reflekton mbështetjen e saj kundrejt rrjetit të SEEMHN, objektivi kryesor i të cilit është të përhapë njohuri mbi historinë dhe politikën monetare të Evropës Juglindore, si pjesë integrale e përvojës Evropiane.

Tema e kësaj konference ishte: “Rrëfimi i dy krizave: Depresioni i Madh dhe Recesioni i Madh në Evropën Juglindore (paralele, administrimi i krizave dhe Ristrukturime të sektorit bankar)”.

Të ftuar specialë në këtë konferencë ishin Nicos Christodoulakis, profesor pranë Universitetit të Athinës për Ekonomi e Biznes (AUEB) dhe London School of Economics (LSE), si dhe Pierre Siklos, profesor pranë Wilfried Laurier University, të cilët mbajtën edhe dy fjalimet kryesore.

Më poshtë mund të gjeni një renditje të temave të prezantuara në këtë konferencë:

- “Recesioni i madh: Qëndrueshmëria makroekonomike, rregullimi dhe institucionet bankare”, nga Lucia Dalla Pellegrina dhe Donato Masciandaro, Universiteti Bocconi.
- “Shkaqe dhe pasoja të prishjes së standardit të floririt ndërmjet dy luftërave mbi Evropën Juglindore”, nga Matthias Morys, University of York.
- “Déja vu? Eksperiencia e krizës greke, viti 2010 kundrejt viteve 1930. Mësime nga historia”, nga George Chouliarakis dhe Sophia Lazaretou, Banka e Greqisë.

- “Një rrëfim i dy ortodoksive: Ekonomia bullgare gjatë Depresionit të Madh dhe Recesionit të Madh”, nga Martin Ivanov, Akademia Bullgare e Shkencave.
- “Mësime dhe eksperiencia të marra gjatë krizës financiare globale: rasti i Turqisë”, nga Yuksel Görmez dhe Serkan Yigit, Banka e Turqisë.
- “Efektet e krizës greke mbi Evropën Juglindore: Evidencë e përditësuar”, nga Dominik Bernhofer, Banka e Austrisë.
- “Reformat financiare dhe trashëgimitë historike në tranzicion”, nga Elira Karaja (IMT Lucca dhe UC Berkeley) dhe Laura Cojocar, Delaware University.
- “Sfidat e zhvillimit ekonomik dhe kërkesat financiare për të plotësuar hendekun financiar”, nga Petra Milo, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- “Impakti i kujtesës së inflacionit të lartë mbi besimin e familjeve të monedha”, nga Elisabeth Beckmann dhe Thomas Scheiber, Banka e Austrisë.
- “Impakti i krizës mbi ekonominë shqiptare”, nga Ardian Fullani, Altin Tanku dhe Lorena Skufi, Banka e Shqipërisë.
- “Vlerësime alternative të pozicionit fiskal në Shqipëri”, nga Anjeza Gazidede, Banka e Shqipërisë.
- “Teoritë e tregtisë ndërkombëtare të Michail Manoilescu në retrospektivë: si dhe kur duhet të mbrohen ekonomitë në zhvillim?”, nga Nikolay Nenovski (University of Amiens) dhe Dominique Torre (University of Nice Sophia Antipolis-CNRS).
- “Qëndrueshmëria fiskale në Bashkimin Evropian dhe vende të

tjera kandidate”, nga Gerti Shijaku, Banka e Shqipërisë.

### ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË - VITI 2012

Për të gjashtin vit radhazi Banka e Shqipërisë organizon aktivitetin “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë”. Ky çmim inkurajon studentët shqiptarë të diplomuar gjatë këtij viti, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në çështje të lidhura me ekonomiksion monetar, stabilitetin financiar, integrimin ekonomik të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë në përgjithësi. Ky aktivitet përfaqëson një traditë të mirë që shërben për krijimin e një kulture kërkimesh dhe krijimin e një strukture mbështetëse me elementë të rinj, të cilët nuk kanë vetëm dëshirën, por edhe njohuritë e nevojshme për të studiuar.

Çmimin e parë e fitoi z. Alqi Bllako, student në Universitetin e New Yorkut në Tiranë me temën e tij të masterit “Roli i tatimit mbi të ardhurat e kompanive në strukturën e kapitalit: Të dhëna mbi ekonominë shqiptare”. Çmimi i dytë u fitua nga zj. Dirina Mançellari, studente në Universitetin Amerikan të Bullgarisë me temën “Një kuadër për vlerësimin e qëndrueshmërisë së financave publike në Shqipëri”. Ndërsa, çmimi i tretë u fitua nga z. Jurgen Koplaku, student në Universitetin Bocconi në Itali me temën “A u prek struktura e kompanive evropiane nga kriza financiare 2007-2008?”.

### SEMINARI TEKNIK

Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit

të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon brenda departamentit, Seminarin Teknik, me karakter informativ mbi çështje, dukuri apo fenomene të ndryshme me interes. Në paragrafin më poshtë do të gjeni një përmbledhje të seminareve të zhvilluara gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2012.

- i. “Buxheti i ekonomive familjare në Shqipëri, 2006-2007”, nga Enkela Gaçaj.

Qëllimi i këtij seminari ishte prezantimi i një pjesë së databazës me të dhëna mikro të Departamentit të Kërkimeve. Baza kryesore e të dhënave është marrë nga Anketa e Buxhetit të Familjes, e kryer nga INSTAT për periudhën tetor 2006 - nëntor 2007. Analizimi i të dhënave, u bë jo vetëm sipas shpërndarjes së të ardhurave dhe strukturës së shpenzimeve sipas prefekturave, por bazuar edhe në karakteristikat kryefamiljarit si grupmosha, niveli i arsimimit, statusi i punësimit etj.

- ii. “Luhatjet surprizë makroekonomike dhe kursi i këmbimit”, nga Bledar Hoda.

Materiali i paraqitur në këtë seminar është një shtjellim teorik i efektit që luhatjet surprizë (të paparashikuara) të treguesve makroekonomikë, kanë në kursin e këmbimit. Në bazë të këtij kuadri është modelimi i kursit të këmbimit ndaj faktorëve makroekonomikë, bazuar në paritetin e fuqisë blerëse, funksionin e kërkesës për para dhe paritetit të pambuluar të interesave. Modelimi i kursit bazuar në këto blloqe kryesore dhe ripërpunimi i kuadrit, ofron mundësinë e parashikimit të luhatjeve të kursit kundrejt devijimeve të treguesve makro nga vlerat e pritura të këtyre faktorëve.

- iii. “Mikrofinancimi në Shqipëri, analiza e një trendi në rritje”, nga Arlind Rama.

Nisur nga trendi rritës që ka njohur mikrofinancimi në ekonominë shqiptare, ky prezantim synonte të ofronte një analizë mbi ecurinë e këtij sektori përgjatë viteve të fundit. Të dhënat mbi aktivitetin e institucioneve të mikrofinancës u morën nga databaza e MIX Market dhe nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë. Vëmendje iu kushtua gjithashtu riskut që paraqet mikrofinancimi rural në vend, si sfida që u kushtëzon këtyre institucioneve një *trade-off* mes shtrirjes gjeografike dhe konsolidimit financiar.

### **FTESË PËR PJESMARRJE NË SEMINARIN E SË PREMTES, GJATË VITIT 2013**

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Bankare, pranë Departamentit të Kërkimeve, rifillon aktivitetin e “Seminarit të së Premtes”, për vitin 2013.

Ftojme të gjithë kërkuesit dhe studiuesit, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë, të marrin pjesë në këtë aktivitet, duke prezantuar dhe diskutuar materialet e tyre me karakter empirik dhe/ose teorik. Pjesëmarrësit kanë mundësinë të përfitojnë nga shkëmbimi dhe marrja e ideve të reja për temën e tyre, duke përmirësuar në këtë mënyrë kërkimin shkencor, si brenda ashtu edhe jashtë Bankës së Shqipërisë.

Në rast se dëshironi të merrni pjesë në “Seminarin e së Premtes”, materialin mund ta dërgoni në adresën e email-it: [bhaxhimusaj@bankofalbania.org](mailto:bhaxhimusaj@bankofalbania.org).

**LINQE:**

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Bank of Finland ([http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit\\_julkaisut/index.htm](http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm))

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Deutsche Bundesbank ([http://www.bundesbank.de/vfz/vfz\\_diskussionspapiere\\_2009.en.php](http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php))

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Oesterreichische Nationalbank ([http://www.oenb.at/en/presse\\_pub/research/research.jsp](http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp))

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)





Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.  
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", nr.24, Tiranë  
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3  
Faks: + 355 4 2419408  
E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)  
[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)